



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI

ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale lidhur me nenin 78 të Statutit të Komunës së Gjilanit e në zbatim të nenit 7 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik dhe nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, Kryetari i Komunës në cilësinë e Organit më të Lartë Administrativ merr:

V E N D I M

P Ë R

LEJIMIN E PAGESËS SË ORËVE TË PUNUARA JASHTË ORARIT PUNUES

1. Nëpunëses së Shërbimit Publik, Shqipe Nuhii e emëruar në pozitën punuese; Profesor i Arkitekturës në Shkollën e Mesme të Lartë "Mehmet Isai" Gjilan, në kuadër të Drejtorisë të Arsimit, i Lejohet pagesa e orëve të punuara jashtë orarit punues në DUPMM për shkak të nevojave emergjente – mungesës së stafit në këtë Drejtori për muajt; janar 32 orë pune dhe shkurt 2023 32 orë pune gjithë sejtë 64 orë pune;

1.1 Shqipe Nuhii.....278 €

2. Pagesa e lejuar e orëve të punuar jashtë orarit punues nga pika 1 e këtij vendimi duhet bërë nga kodi buxhetor, paga dhe mëditje e institucionit shkollor – DKA ku nëpunësja punon për shkak të pa mundësisë së pagesës nga kodi buxhetor paga dhe mëditje i DUPMM.

3. Orët e punuara jashtë orarit punues nga pika 1 e këtij vendimi janë llogaritur sipas nenit 7 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë dhe nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është: Vendimi për caktimin e nëpunëses së shërbimit publik për punë jashtë orarit punues 02/585 i dt;17.08.20225, regjistri i vijimit në punë i nëpunëses në DUPMM për muajt: janar dhe shkurt 2023, raporti i punës për mbikëqyrjen e punimeve në ndërtimin e rrugës "Livoq i Ulët-Livoq i Epërm" dhe ndërtimi i rrugëve në Fsh. Bresalc-Lagjësja e shkollave i vërtetuar nga ana e drejtorit të DUPMMN.

5. Vendimi hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit.

Vendimi ti dorëzohet;
Drejtorit të D. arsimit
Drejtorit të DUPMM
Nëpunëses,
Arkivit

